



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.3/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj, kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) parashtruar kundër Vendimit Nr. 01/3438 — 2025, dt. 26.11.2025 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për Miratimin e Qendrave të Votimit Jashtë Kosovës, Numrin e Vendvotimeve dhe Numrin Maksimal të Votuesve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 30.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa ZP.A.nr.3/2025, e datës 27.11.2025 e parashtruar nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET Vendimi Nr.01/3438- 2025, i datës 26.11.2025 i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, sa i përket Qendrave të Votimit jashtë Kosovës, numrit të vendvotimeve si dhe listën e qendrave të votimit, ashtu që si Qendra të Votimit jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me 28 dhjetor 2025, caktohen përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësirat e tyre.

II. Lista e Qendrave të Votimit, si në pikën I të këtij vendimi përbëhet vetëm nga Qendrat e Votimit në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësirat e tyre.

A r s y e t i m

Me datë;27.11.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e paraqitura nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e mbajtur më 26.11.2025 përveç tjerash ka diskutuar edhe rreth organizimit të procesit të votimit jashtë vendit. Në këtë mbledhje, pavarësisht kontestimit të bazuar të ligjshmërisë që i është bërë propozimit për të krijuar "Qendra Alternative të Votimit" jashtë hapësirave zyrtare të misioneve tona diplomatike, vendimi (Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Nr. 01/3438 — 2025, dt. 26.11.2025) është marrë me shumicë votash në këtë institucion duke provuar kështu të imponojnë "një formë të re" të organizimit të zgjedhjeve, me gjasë, më e përshtatshme për subjektin sponzorues të kësaj ideje.

Marrë parasysh legjislationin zgjedhor në vendin tonë, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullat Zgjedhore: Nr.05/2024 dhe 04/2025, Vendimi i ankimuar në këtë rast është në kundërshtim flagrant me këto akte që përbëjnë bazën kryesore dhe të vetme për organizimin e zgjedhjeve në Republikën e Kosovës por edhe bazuar në Kushtetutën e vendit, dhe si i tillë, me qëllim të rivendosjes së ligjshmërisë, duhet të anulohet sepse: në bazë të nenin 96, paragrafi 3 të LZP votimi jashtë vendit, përveç votimit përmes postës, mund të organizohet që votuesit jashtë vendit mund të votojnë: "fizikisht, në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësira të tyre... ' prandaj krijimi i Qendrave shtesë të Votimit jashtë hapësirave zyrtare nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përbënë "shpikje" të një vendi/hapësire të re — shtesë dhe mënyre të re të organizimit të zgjedhjeve dhe nxjerrë një kategori të tretë të votuesve jashtë vendit (Votuesit që votojnë në hapësira të siguruara enkas jashtë përfaqësive diplomatike) krahas dy kategorive ligjore që janë: 1. Votuesit që votojnë përmes postës dhe 2. Votuesit që votojnë në përfaqësi diplomatike.

Pra, paragrafi 3.1 i nenit 96 të LZP qartësisht dhe saktësisht rregullon mënyrën përcaktimit të Qendrave të Votimit jashtë vendit si dhe mënyrën e organizimit të zgjedhjeve, prandaj Vendimi i ankimuar i KQZ-së duke qenë në kundërshtim me dispozitat në fjalë dhe duke qenë se përbënë "zgjidhje të re" për votuesit jashtë vendit përtej dy zgjidhjeve (dy mënyrave të votimit) që i përcakton ligji, është totalisht i pavlerë sepse cenon rëndë dhe në mënyrë serioze integritetin dhe besimin e qytetareve dhe pjesëmarrësve (si garues) në procesin e organizimit të zgjedhjeve.

Më tej në ankesë theksohet se KQZ, është institucion i pavarur kushtetues-përgjegjës për organizimin e zgjedhjeve dhe referendumeve në vendin tonë, puna e së cilës duhet të mbështet në Kushtetutë, ligjet përkatëse dhe rregullat zgjedhore. Prandaj nëse analizohen me kujdes autorizimet kushtetuese dhe ligjore të KQZ-së, vërejmë se Vendimi në fjalë përbënë në mënyrë të pakontestueshme një akt Ultra Vires (tejkallim i autorizimeve) nga ana e këtij institucioni i cili në asnjë rast dhe në asnjë formë nuk e ka të drejtën e "krijimit" të normave të reja të cilat krijojnë të drejta ose detyrime shtesë apo procedura të reja sepse kjo e drejtë në Republikën e Kosovës është e drejtë ekskluzive e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sipas parashtruesit të ankesës KQZ, gjatë organizimit të zgjedhjeve duhet të veprojë vetëm në përputhje me ligjin, kërkesë kjo për respektimin e Parimit të Legalitetit e përcaktuar me nenin 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Pra krijimi i një forme shtesë - të re votimi jashtë vendit, ashtu siç nuk është paraparë me ligj, përbënë tejkallim flagrant të kompetencave të këtij institucion sepse përveç tjerash ky vendim krijon rreziqe të shumta e serioze ligjore e institucionale si: nuk mund të garantohet siguria e procesit zgjedhor në hapësira jo të parapara me ligj, nuk mund të sigurohet transparencë meqë ato janë hapësira jashtë hapësirave të përfaqësive diplomatike vendi i të cilave është i njohur për qytetarët tonë, hapë derën për ndërhyrje të palëve të treta e manipulime çfarë sjellë ma pas edhe kontestime të procesit zgjedhor, si dhe cenon integritetin/besimin e procesit zgjedhor.

KQZ, gjatë planifikimit dhe ndarjes së buxhetit për Zgjedhjet e jashtëzakonshme që do të mbahen më 28 dhjetor, nuk ka kërkuar e as paraparë mjete buxhetore për marrjen me qera të hapësirave të tilla.

SKQZ, në shkresën drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kishte kërkuar informata vetëm "për numrin e të gjitha përfaqësive diplomatike bashkë me detajet e nevojshme mbi hapësirën e këtyre objekteve me qëllim që të bëhet vlerësimi dhe të përcaktohet numri i vendvotimeve dhe votuesve në ato përfaqësi" që është kërkesë tërësisht e mbështetur në ligj. Por, duke tejkaluar kërkesën e qartë dhe krejtësisht ligjore të Sekretariatit të KQZ-së, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përveç informative të kërkuara, kishte dërguar edhe një listë të "Qendrave alternative të votimit" jashtë përfaqësive diplomatike, në mënyrë të paprecedentë në organizimin e zgjedhjeve në Republikën e Kosovës.

Kërkesa e sekretariatit të KQZ-së drejtuar MPJD ishte bërë me qëllim, sepse gjatë organizimit të zgjedhjeve të rregullta për Kuvendin e Kosovës të po këtij viti në 22 shtete — në 35 përfaqësi diplomatike numri i përcaktuar nga KQZ për të votuar ishte 47 000 ndërkohë gjatë 4 muajve sa kishin afat për t'u regjistruar (në zgjedhje të rregullta) janë regjistruar 20399 ndërsa kanë votuar 15352, që i bie se në asnjërin nga përfaqësitë diplomatike nuk është tejkaluar numri i paraparë dhe i mundshëm për të votuar, çfarë tregon hapur se nuk ka asnjë dëshmi që për votimin jashtë vendit duhet të sigurohen hapësira shtesë jashtë përfaqësive diplomatike.

Gjithashtu, është me rëndësi të theksohet fakti se, mbështetur në Konventat ndërkombëtare përmes të cilave rregullohen aspekte të ndryshme të veprimit, për organizimin e çfarëdo procesi jashtë përfaqësive diplomatike duhet të plotësohen disa kushte si për shembull Gjermania (ku parashihet hapja e numrit më të madh të Qendrave alternative të votimit) kërkon që: të tregohen vendet në të cilat do të mbahen zgjedhjet zbatimi është I mundur vetëm në ambiente diplomatike dhe konsullore dhe autoritetet gjermane të njoftohen për këtë dhe detaje tjera 3 muaj para datës së zgjedhjeve.

Zvicra (ku gjithashtu planifikohet hapja e Qendrave alternative) kërkon gjithashtu që të njoftohet 3 muaj përpara për mbajtjen e zgjedhjeve në ambiente diplomatike. Zvicra parasheh mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve edhe në ambiente jashtë përfaqësive diplomatike por duhet kërkuar leje përmes Notës Verbale nga Departamenti Federal për Punë të Jashtme dhe se këto hapësira nuk gëzojnë mbrojtje sipas Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike 1961 dhe mbi marrëdhëniet konsullore 1963.

Mbretëria e Bashkuar parasheh mundësinë që shtetasit e huaj të votojnë në këtë shtet por vetëm në misionet diplomatike – konsullore. Pra shtetet kanë rregullat e tyre me të cilat janë të njoftuara edhe MPJD e edhe KQZ e që e bëjnë tërësisht të pamundur organizimin e procesit zgjedhor në formën e përcaktuar me Vendimin e KQZ-së i cili po atakohet pran organit të PZAP-it. Kërkojnë shfuqizimin e menjëhershëm të Vendimit nr.01/3438 — 2025, dt. 26.11.2025, të KQZ-së, i cili parasheh mundësinë e krijimit JASHTËLIGISHËM të Qendrave Alternative të Votimit për votuesit jashtë vendit. Bashkangjitur në ankesë janë shkresat: buxheti i aprovuar nga KQZ, vendimin i KQZ-së nr.01/3438 — 2025, dt. 26.11.2025, shkresa e SKQZ-së, drejtuar MPJD, shkresa e MPJD ku janë të përfshira lista e përfaqësive diplomatike, dhe lista e Qendrave alternative

Në përgjigjen në ankesë KQZ, sqaron se bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 2 paragrafi 2.2 të Rregullores Zgjedhore Nr.05/2024, Themelimi dhe Menaxhimi i Qendrave të Votimit, si dhe nenin 12 të Rregulloren Zgjedhore Nr. 04/2025 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, përcaktohet procedura e krijimit të Qendrave të Votimit.

Sekretariati i KQZ-së, më datë 20.11.2025, ka kërkuar nga MPJD lista e përfaqësive diplomatike dhe të dhënat mbi hapësirat fizike të tyre për organizimin e procesit të votimit jashtë Kosovës.

Më 25.11.2025, KQZ ka pranuar nga MPJD dy dokumente zyrtare: hapësirat e konfirmuara nga misionet diplomatike dhe propozimet për hapësira shtesë jashtë objekteve të tyre.

Në të njëjtën datë, KQZ ka ftuar përfaqësuesit e MPJD-së për një takim vlerësues, i cili është mbajtur më 26.11.2025 në KQZ, ku janë analizuar hapësirat e propozuara dhe janë përcaktuar qendrat e votimit, vendvotimet dhe kapacitetet maksimale të votuesve për secilën prej tyre.

Më tej në përgjigje KQZ, thekson se hapja e qendrave të votimit në Misione Diplomatiqe dhe hapësira shtesë për votim jashtë Kosovës është shqyrtuar në mbledhjen nr. 84 të KQZ-së të datës 26.11.2025 dhe është miratuar vendimi për organizimin e votimit në 50 përfaqësi diplomatike me gjithsej 66 vendvotime, në 36 shtete, si dhe me kufizim prej 950 votues për çdo vendvotim dhe kapacitet maksimal prej 62700 votuesish në total, duke u lënë mundësinë e rishikimit bazuar në numrin përfundimtar të aplikimeve. Gjithashtu, sipas vendimit, Qendra të Votimit do të hapen edhe në hapësira shtesë jashtë përfaqësive diplomatike, siç janë propozuar nga MPJD-ja, me gjithsej 10 Qendra të Votimit (5 në Gjermani, 3 në Zvicër, 1 në Mbretërinë e Bashkuar dhe 1 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës), me 43 vendvotime dhe kapacitet maksimal prej 40,850 votuesish.

Gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, nuk është arritur konsensus mes Anëtarëve të KQZ-së lidhur me përdorimin shtesë jashtë përfaqësive -diplomatike, pasi pati interpretime të ndryshme të nenit 96, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-228, i cili përcakton se votimi jashtë Kosovës organizohet nga KQZ-ja dhe votimi fizik mund të zhvillohet në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës apo në hapësirat e tyre të adaptuara për qendra votimi, sipas kriterëve të vendosura nga KQZ-ja.

Lidhur me këtë çështje në KQZ vendimi është marr me shumicë të votave, respektivisht me 6 vota për dhe 5 kundër. Qëndrimi i shumicës ishte se me rastin e ndryshimeve ligjore kur është vendosur për të lejuar votimin e votuesve jashtë vendit në përfaqësi diplomatike dhe hapësira të tyre, qëllimi i ligjvënësit ishte të lehtësohej votimi i diasporës, procesi të jetë sa më gjithëpërfshirës si një nga parimet qenësore të procesit zgjedhor, dhe çdo interpretim i ligjit në këtë aspekt duhet të interpretohet në favor të gjithë përfshirjes apo lehtësimit të votimit të votuesve jashtë vendit. Në anën tjetër qëndrimi i pakicës së votave në KQZ, kjo çështje duhet të ketë interpretim të ngushtë, respektivisht që votimi të mbahet ashtu siç përcakton në mënyrë shprehimore ligji, pra në përfaqësi diplomatike dhe hapësirat e tyre, ku fjalia "hapësirat e tyre" sipas Konventës së Vjenës konsiderohen vetëm hapësirat ku gjendet përfaqësia diplomatike dhe hapësirat që shfrytëzohen e që njihen nga shteti pritës.

Duke pas parasysh qëndrimin e kundërt nga anëtarët e KQZ dhe nevojën që kjo çështje të ketë interpretim përfundimtar nga institucionet gjyqësore, qëndrimi i shumicës në këtë fazë është i nevojshëm që të mos shkaktohet dëm në proces të regjistrimit të votuesve jashtë vendit, gjegjësisht të mos shkaktohen vonesa, pasi që periudha e regjistrimit të votuesve jashtë vendit është vetëm 10 dite (nga 26 nëntor deri me 6 dhjetor), dhe vonesat do të mund të shkaktonin pamundësinë e aplikimit të votuesve.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

PZAP vlerëson se qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se, me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ, Vendimi Nr. 01/3438- 2025, i datës 26.11.2025 për Miratimin e Qendrave të Votimit Jashtë Kosovës, Numrin e Vendvotimeve dhe Numrin Maksimal të Votuesve, nuk janë respektuar dispozitat ligjore nga neni 96 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenin 2 paragrafi 2.2 i Rregullore Zgjedhore Nr,05/2024, Themelimi dhe Menaxhimi i Qendrave të Votimit.

Me dispozitën e nenit Neni 96. 3 i Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, parashihet që: 3. “Votimi jashtë Kosovës organizohet nga KQZ-ja dhe votuesit mund të votojnë duke u përcaktuar individualisht për mënyrën e votimit, në momentin e regjistrimit përmes platformës së KQZ-së:

- 3.1. fizikisht, në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësira të tyre, të cilat shndërrohen në qendra të votimit sipas kriterëve të përcaktuara nga KQZ-ja për adaptimin në qendra të votimit. Kjo mënyrë votimi nuk aplikohet në zgjedhje lokale;
- 3.2. duke dërguar fletëvotimet përmes kutisë postare të KQZ-së, në postën e Kosovës;
- 3.3. duke dërguar fletëvotimet përmes postës në një nga kutitë postare të hapura nga KQZ-ja përmes dhe me lehtësimin e përfaqësive diplomatike, jashtë Kosovës.

Me dispozitën e Nenit 2 paragrafi 2.2 i Rregullore Zgjedhore Nr,05/2024, Themelimi dhe Menaxhimi i Qendrave të Votimit, parashihet që QV themelohen “në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës, për votim jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare “Paneli vlerësoi se procesin e votimit jashtë Kosovës përveç dispozitave të lartpërmendura e rregullon Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme Neni 96 edhe paragrafët: 6. KQZ, përmes akteve nënligjore, përcakton kriteret dhe kushtet që duhet të përmbushin objektet e përfaqësive diplomatike të shndërruara në hapësira votimi, si dhe përcakton numrin maksimal të votuesve që mund të votojnë, për secilën përfaqësi diplomatike.7. KQZ, përmes aktit nënligjor, rregullon mënyrën e regjistrimit për votim në përfaqësi diplomatike, mënyrën e votimit, mbikëqyrjes, vëzhgimit, shpërndarjes, paketimit dhe dërgimit të materialit të votimit dhe të gjitha çështjet tjera që ndërlidhen me votimin për shtetasit jashtë vendit. 8. KQZ-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, vlerëson hapësirat fizike për secilën përfaqësi diplomatike dhe, në përputhje me kriteret e përcaktuara, merr vendim për numrin e vendvotimeve dhe për numrin e votuesve për secilën përfaqësi diplomatike. Jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e shpalljes së datës së zgjedhjeve, KQZ kërkon nga MPJ, listën e të gjitha përfaqësive diplomatike, bashkë me detajet e nevojshme mbi hapësirën e objekteve. Ministria e Punëve të Jashtme obligohet që t’i ofrojë KQZ-së të gjitha informacionet e kërkuara brenda tre (3) ditë, nga dita e pranimi të kërkesës. MPJ përshtat hapësirat e objekteve të përfaqësive diplomatike në vendvotime sipas kriterëve të përcaktuara nga KQZ.PZAP vlerëson se pretendimet e KQZ të shprehura përmes përgjigjes në ankesë se qëndrimi i shumicës në këtë fazë ka qenë i nevojshëm që të mos shkaktohet dëm në proces të regjistrimit të votuesve jashtë vendit, gjegjësisht të mos shkaktohen vonesa, janë pretendime të paqëndrueshme për faktin se me dispozitën ligjore të nenit 96.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Nr.08/L-228) në mënyrë

shprehimore dhe të qartë është paraparë se “*Votimi jashtë Kosovës organizohet nga KQZ-ja dhe votuesit mund të votojnë duke u përcaktuar individualisht për mënyrën e votimit, në momentin e regjistrimit përmes platformës së KQZ-së: 31.1. fizikisht në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësirat e tyre....*”. Po ashtu edhe në Rregulloren Zgjedhore Nr.05.2024 për themelimin e dhe Menxhimin e Qendrave të Votimit, përkatësisht në nenin 2 parashihet se “*Qendrat e Votimit themelohen në :..... 2.2.në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës , për votim jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare*”, andaj sipas panelit me dispozita ligjore askund nuk është e paraparë e drejta e krijimit të qendrave të votimit jashtë hapësirave të përfaqësive diplomatike, andaj nga kjo rezulton se themelimi i qendrave të votimit për votim jashtë Kosove jashtë hapësirave të misionëve diplomatike, nuk mund të konsiderohen si qendra të vlefshme të votimit, krejt kjo me qëllim të garantimit të integritetit zgjedhor, pasi që krijimi i qendrave të votimit jashtë përfaqësive diplomatike mund të cenojë integritetin zgjedhor.

Tutje PZAP vlerëson se lejimi i qendrave të votimit vetëm brenda hapësirave të përfaqësive diplomatike është paraparë si masë mbrojtëse për të siguruar integritetin e votës dhe kjo asesi nuk mund të parashihet si pengesë në ushtrimin efektiv të të drejtave të votimit të shtetasve të Republikës së Kosovës që banojnë jashtë territorit të Kosovës. Paneli vlerëson se Republika e Kosovës iu ka garantuar të drejtën e votës edhe shtetasve që jetojnë jashtë vendit, mirëpo e njëjta gjithashtu ka përcaktuar edhe kushte ligjore për ushtrimin e të drejtës në fjalë.

Pra Paneli vlerëson se procesi i votimit jashtë Kosovës është rregulluar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 96 i këtij ligji përcakton shprehimisht dispozitat për zhvillimin e procesit zgjedhor jashtë Kosovës, ku paragrafi 3 pika 3.1 parasheh që (3) Votimi jashtë Kosovës organizohet nga KQZ-ja dhe votuesit mund të votojnë duke u përcaktuar individualisht për mënyrën e votimit, në momentin e regjistrimit përmes platformës së KQZ-së: dhe (3.1.) fizikisht, në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësira të tyre, të cilat shndërrohen në qendra të votimit sipas kriterëve të përcaktuara nga KQZ-ja për adaptimin në qendra të votimit. Pra këto dispozita nuk lejojnë alternativë përkatësisht shtim të Qendrave të votimit jashtë përfaqësive diplomatike, pasi që shprehimisht parashohin se votimi mbahet vetëm në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësira të tyre, të cilat shndërrohen në qendra të votimit sipas kriterëve të përcaktuara nga KQZ-ja, si dhe Rregullorja Zgjedhore e KQZ-së 05/2024 neni 2 par. 2 pika 2.2 parasheh se Qendrat e vendvotimit themelohen në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës, për votim jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare, pra sipas Panelit duke qenë se caktimi i vendvotimeve jashtë Kosovës është i përcaktuar me ligj, qëllimi i ligjvënësit është që të përcaktohen saktë vendvotimet jashtë Kosovës pra duke i kufizuar vetëm në Përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës, e që sipas Panelit është një qëllim legjitim që është synuar të arrihet me këtë kufizim për të garantuar integritetin e procesit të votimit jashtë Kosovës, e i cili kufizim nuk do të ndikon në shprehjen e lirë të vullnetit të popullit përkitazi me përfaqësuesit e tyre në Kuvend duke qenë se me këtë përcaktim të vendvotimeve jashtë Kosovës nuk u pamundësohet votimi, pasi që votuesit jashtë Kosovës kanë të drejtë dhe mund të votojnë në fizikisht, në Përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësira të tyre, duke dërguar fletëvotimet përmes kutisë postare të KQZ-së në postën e Kosovës dhe duke dërguar fletëvotimet përmes postës në një nga kutitë postare të hapura nga KQZ-ja përmes dhe me lehtësimin e përfaqësive diplomatike, jashtë Kosovës ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli vlerëson se ligjvënësi nuk lejon fare alternativë për Qendrat e votimit jashtë Kosovës duke i përcaktuar si Qendra të votimit të vetme Përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësirat e tyre, kjo edhe për faktin se sipas Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës rregullohet edhe organizimi i zgjedhjeve ku neni 96 par.4 parasheh se Votimi në përfaqësi diplomatike organizohet një ditë para ditës së zgjedhjeve në Kosovë..., neni 96 par.6 parasheh, KQZ, përmes akteve nënligjore, përcakton kriteret dhe kushtet që duhet të përmbushin objektet e përfaqësive diplomatike të shndërruara në hapësira votim..., neni 96 par.7 parasheh KQZ, përmes aktit nënligjor, rregullon mënyrën e regjistrimit për votim në përfaqësi diplomatike, mënyrën e votimit, mbikëqyrjes, vëzhgimit, shpërndarjes, paketimit dhe dërgimit të materialit të votimit dhe të gjitha çështjet tjera që ndërlidhen me votimin për shtetasit jashtë vendit, neni 96 par. 8 parasheh, KQZ-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, vlerëson hapësirat fizike për secilën përfaqësi diplomatike..., neni 96 par. 10. Parasheh KQZ mbulon shpenzimet e këshillave të vendvotimit dhe ekipeve që angazhohen për të organizuar votimin në përfaqësi diplomatike..... neni 96 par 11 parasheh Ekipet që angazhohen me qëllim të votimit jashtë vendit, alokohen në listën votuese në përfaqësi diplomatike për të mos i humbur e drejta e votimit. Pra në tërësi procesi i votimit jashtë Kosovës është i përcaktuar që të organizohet dhe mbahet në Përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës, jo edhe në vendet tjera jashtë Përfaqësive diplomatike të Republikës së Kosovës

Paneli vlerëson se alternativë lejohet vetëm për qendrat e votimit brenda vendit dhe atë sipas Rregullores Zgjedhore e KQZ-së 05/2024 neni 2 par. 2 pika 2.1 parasheh se Qendrat e votimit themelohen në ndërtesa të institucioneve publike, me prioritet në objektet arsimore, kulturore, sportive dhe të ngjashme, ndërsa par. 3 i kësaj rregullore parasheh se në rastet kur nuk mund të aplikohet paragrafi 2.1 i këtij neni KQZ me vendim cakton vendndodhjen e QV në ndërtesa private, në pronësi të personave fizikë ose juridikë, apo hapësira tjera alternative.

Nga të lartpërmendurat si dhe bazuar në shkresat e lëndës Paneli vlerëson se KQZ me vendimin Vendimi Nr. 01/3438- 2025, i datës 26.11.2025 për Miratimin e Qendrave të Votimit Jashtë Kosovës, Numrin e Vendvotimeve dhe Numrin Maksimal të Votuesve, nuk ka respektuar dispozitat e lartcekura lidhur me krijimin e qendrave të votimit jashtë Kosovës, sepse shprehimisht KQZ ka për obligim që vendndodhjen e qendrave të votimit ta caktoj në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës, për votim jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare. Themelimin e qendrave të votimit KQZ duhet të bëjë sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me ligj dhe aktet nënligjore dhe vendndodhja e tyre të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara. Paneli ka vendosur që të ndryshoj vendimin e atakuar sa i për ketë themelimin të Qendrave të Votimit për votuesit jashtë vendit. Prandaj, nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenit 119 paragrafi 3 dhe 5 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e aprovuar ankesën si të bazuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZP.Anr.3/2025, datë;30.11.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.